
	<b>Programi i Pajtueshmërisë së OST</b>	
		<i>Paqe 1 nga 7</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

**Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) të KOSTT-it**  
**(“Programi i Pajtueshmërisë”)**

**shtator 2019**

	 <b>Programi i Pajueshmërisë së OST</b>	<i>Zyrtari i Pajueshmërisë së OST</i>
<i>Page 2 nga 7</i>		

## Përmbajtja

Historiku.....3

Hyrje.....3

Emërtimi i Zyrtarit për Pajueshmëri të OST .....3

Vlerësimi vjetor i pajueshmërisë .....5


Trajtimi .....5

Informacionet e ofruara nga KOSTI për personat që ushtrojnë kontroll mbi KEK SH.A./Ibër Lepenc SH.A.....6

Detjat e OST-së.....6

Vonesa ose braktisja e investimeve të planifikuara.....6

Vlefshmëria dhe hyrja në fuqi e Programit të Pajueshmërisë .....7

	Programi i Pajtuëshmërisë së OST	
		Paqe 3 nga 7
Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST		

## Historiku

Operatori i Sistemit të Transmetimit (KOSTT) ka përgatitur këtë Program të Pajtuëshmërisë në përputhje me dispozitat e nenit 21 të Direktivës Nr. 2009/72/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit lidhur me Rregullat e përbashkëta për Tregjet e Brendshme për Energji Elektrike e datës 13 korrik 2009, dhe nenit 21 të Rregullës për Certifikimin e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit, Rregulla ZRRE/Nr. 14/2017 (prill 2017), e cila e obligon OST-në që ta hartoj atë dhe ta dorëzoj të njëjtin pranë Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për miratim.

Po ashtu me 15 shkurt 2019 ('data e certifikimit'), Zyra e Rregullatorit për Energji (në vijim Rregullatori) nxjerri vendimin për miratimin përfundimtar duke konfirmuar Certifikimin e KOSTT SH.A. si OST. Në bazë të këtij vendimi, KOSTT-it i është vendosur detyrimi për të hartuar Programin e Pajtuëshmërisë, si dhe për të emëruar Zyrtarin për Pajtuëshmëri, dhe për të njëjtët të kërkojë miratim nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

## Hyrje


Ky Program i Pajtuëshmërisë përshkruan programin e masave që KOSTT do të ndërmarë për të siguruar operimin e pavarur të rrjetit të transmetimit të Kosovës dhe pajtuëshmërinë me vendimin përfundimtar për certifikim, të nxjerrë nga Rregullatori.

## Emërimi i Zyrtarit për Pajtuëshmëri të OST

KOSTT ka nominuar znj. Mimoza Byqmeti, Zyrtare Ligjore në KOSTT, për të vepruar si Zyrtare e Pajtuëshmërisë së OST lidhur me kërkesat për shthurjen pronësore të vendosura me certifikimin e OST-së. KOSTT ka dërguar biografinë e të njëjtës në Rregullator dhe Bordi i Rregullatorit me datë 14 tetor 2019 (Vendimi V\_1186\_2019) ka emëruar të njëjtën si zyrtare të pajtuëshmërisë së KOSTT-it.

Obligimet dhe detyrat e Zyrtarit për Pajtuëshmëri të OST janë si në vijim:

- monitorimi i zbatimit të Programit të Pajtuëshmërisë së OST-së, siç përshkruhet në këtë program;
- hartimi i një raporti vjetor, ku përcaktohen masat e ndërmarra me qëllim të zbatimit të Programit të Pajtuëshmërisë së OST dhe dorëzimi i tij pranë Rregullatorit;
- dorëzimi i raportit te Bordi i Rregullatorit dhe nxjerrja e rekomandimeve lidhur me Programin e Pajtuëshmërisë së OST, si dhe zbatimi i tij;
- njoftimi i Rregullatorit për çfarëdo shkelje të rëndë sa i përket zbatimit të Programit të Pajtuëshmërisë së OST-së;
- raportimi në Rregullator për çdo marrëdhënie tregtare/ekonomike dhe financiare midis ndonjë ndërmarreje prodhimi ose furnizimi dhe operatorit të sistemit të

	
<b>Programi i Pajtueshmërisë së OST</b>	<i>Page + nga 2</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>	

transmetimit (kjo pothuajse gjithmonë ndërliidhet me kërkesat për kyçe ose shfrytëzim të sistemit, por nuk duhet të përjashtojë edhe marrëdhëniet tjera);


f) pjesëmarrja në takime të KOST (të çfarëdo niveli). Po ashtu pjesëmarrje në të gjitha takimet ku diskutohen:

- i. kushtet për qasje në rrjet, siç përcaktohet në Rregulloren (KE) nr. 714/2009, veganerisht në lidhje me tarifën, shërbimet e gasjes së palëve të treta, shpërndarjen e kapaciteteve dhe menaxhimin e ngarkesave, transparencën, balancimin dhe tregjet dytësore;

- ii. projektet e ndërmarra për të operuar, mirëmbajtur dhe zhvilluar sistemin e transmetimit, duke përfshirë investimet e interkoneksionit dhe kyçjes;
- iii. blerjet ose shitjet e energjisë elektrike të nevojshme për operimin e sistemit të transmetimit;

- g) njoftimi i Rregullatorit për çdo vendim ose veprim nga ana e Qeverisë së Kosovës që mund të parandalojë ose vonojë ndonjë investim që do të bëhet në tri (3) vitet e ardhshme në bazë të planit dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit. publikimi, në fagen e internetit të KOST-it, lidhur me marrëdhëniet ndërmjet *KOST-it* dhe organeve publike kontrolluese të *KEK/HC Ujmani* (d.m.th., MZHE) në lidhje me shkëmbimin e informacioneve dhe zbatimin e kërkesave të raportimit; monitorimi i efektivitetit të praktikave, procedurave dhe sistemeve të miratuara nga licencuari për të siguruar pajtueshmërinë e tij me obligimet dhe detyrat e OST-së, të përkrahura në Programin e Pajtueshmërisë;
- j) sigurimin e trajnimit adekuat të personelit lidhur me gëshitet e pajtueshmërisë; k) keshillimi nëse, për aq sa zbatimin i praktikave, procedurave dhe sistemeve të tilla kërkojnë bashkëpunimin e ndonjë personi tjetër, ato janë krijuar në mënyrë të arsyeshme për të siguruar bashkëpunimin e kërkuar;
- l) përgatitja, paraqitja dhe rishikimi periodik i këtij Programi të Pajtueshmërisë, duke përkrahur masat e pajtueshmërisë së KOST-it.
- m) hetimi i çdo ankese ose përfaqësimi të vënë në dispozicion të Zyrtarit për Pajtueshmëri;
- n) rekomandimi dhe keshillimi për veprimet korrigjuese që cilido hetim i tillë ka treguar se janë të nevojshme ose të dëshirueshme;
- o) raportimi çdo vit tek udhëheqësi i biznesit të KOST lidhur me aktivitetet e Zyrtarit dhe për Pajtueshmëri në lidhje me obligimet dhe detyrat e KOST-së gjatë vitit të kaluar;

<sup>1</sup> Shih opinionin e EnCS, Pjesa III, paragrafi i fundit, <https://www.energy-community.org/Research-Result.html>

	Programi i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Paqe 5 nga 7</i>
Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST		

- p) ofrimi i këshillave dhe informacioneve për KOSTT (përfshirë drejtorët individualë të të licencuarit-KOSTT) dhe udhëheqësin e biznesit , me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë së të licensuarit me obligimet dhe detyrat e OST-së.

### Vlerësimi vjetor i pajtueshmërisë

Zyrtari për Pajtueshmëri, si pjesë të detyrave të përshkruara më sipër, çdo vit do të bëjë një vlerësim të pajtueshmërisë së OST. Zyrtari për Pajtueshmëri mund të mbështetet nga individë shtesë në kryerjen e vlerësimit. Vlerësimi i Pajtueshmërisë do të rishikojë sistemet, procedurat dhe politikat që janë krijuar për të siguruar pajtueshmërinë e shturjes pronësore . Vlerësimi është i ndarë në shtatë pjesë, përkatësisht:


1. Pronësia e sistemit të transmetimit nga KOSTT,
2. Kontrolli dhe pronësia e KOSTT si OST,
3. Pavarësia e Bordit të KOSTT
4. Pavarësia financiare e KOSTT
5. Përshtatshmëria e burimeve njerëzore,
6. Qasja jodiskriminuese në sistemin e transmetimit (konfidencialiteti i të dhënave), dhe
7. Realizimi i planeve investive të KOSTT

Vlerësimi do të kryhet duke përdorur një model që është zhvilluar posaçërisht për këtë qëllim, dhe i cili mundëson që vlerësimi të kryhet në mënyrë sistematike. Vlerësimi bazohet në një kombinim të intervistave me individë kyç, si të brendshëm të KOSTT-it, sipas nevojës edhe të jashtëm (p.sh. ZRRE) dhe një rishikim të dokumenteve të shkruara. Vlerësimi çon në përcaktimin e një rezultati (notimi) vjetor të pajtueshmërisë, që varion nga 1 (pajtueshmëri e ulët) deri në 4 (pajtueshmëri e lartë). Zhvillimi, zbatimi dhe monitorimi i një plani të veprimit që del nga vlerësimi vjetor është pjesë përbërëse e procesit. Rezultatet e vlerësimit do të jenë pjesë e Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë për Rregullatorin.

### Trajnimi

Trajnimi i stafit dhe ngritja e vetëdijes është një pjesë e rëndësishme e Programit të Pajtueshmërisë. KOSTT ka siguruar trajnim fillestar për Zyrtarin e Pajtueshmërisë dhe stafin e përzgjedhur nga KOSTT, dhe do të vazhdoj sipas nevojës trajnimin për të njëjtit. Vlerësimi i njohurive të stafit rreth pajtueshmërisë shturëse është një aspekt thelbësor i procesit të vlerësimit vjetor dhe, kur është e nevojshme, do të organizoj trajnime për rifreskim të njohurive, sipas rastit.

Pajtueshmëria e KOSTT-it tani është bërë pjesë përbërëse e procesit të induktimit (integritit apo pranimit) të bordit dhe menaxhmentit të lartë të KOSTT-it, për të siguruar që personat me përgjegjësi të bordit dhe menaxhimit në tërë kompaninë të sensibilizohen për pajtueshmërinë e certifikimit.

	<b>Programi i Pajtueshmërisë së OST</b>	<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>
<i>Page 6 nga 7</i>		

## Informacionet e ofruara nga KOSTT për personat që ushtrojnë kontroll mbi KEK SH.A./Ibër Lepenc SH.A.

Nga KOSTT, sipas legjislationit të Kosovës, kërkohet që të bëjë disa parashtrësaraportime rutinore, vjetore pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për qëllime informative dhe, në rrethana të caktuara të kufizuara, pranë Ministrisë së Financave.

Përtej dhe mbi gdo njoftim që KOSTT kërkohet të bëjë tek Rregullatori sipas kushteve të licencës së OST, në raportin vjetor të pajtueshmërisë së OST-së, KOSTT do të specifikojë parashtrësat dhe njoftimet e bëra nga ana e saj për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Financave apo ndonjë tjetër organ të Qeverisë së Kosovës. KOSTT pastaj do të japë konfirmim se asnjë parashtrësë apo njoftim i tillë nuk ka çuar në dhënien, nga qeveria, të ndonjë udhëzimi për KOSTT që lidhet, direkt ose indirekt, me mënyrën në të cilën duhet të përmblushen detrat e saj të OST-së.

## Detrat e OST-së

Ligjet e Kosovës për energjinë, dhe kryesisht Neni 16 i Ligjit për Energjinë Elektrike, kanë të transpozuar plotësisht dispozitat e Direktivës 2009/72/KE në lidhje me detrat dhe përgjegjësitë e OST-së. Vendimi përfundimtar i Rregullatorit për certifikim të KOSTT si OST është bazuar në detrat e OST-së të kryera nga KOSTT, si në datën e certifikimit.

Në raportin e tij vjetor për Rregullatorin, Zyrtari për Pajtueshmëri do të njoftojë Rregullatorin për gdo ndryshim në detrat e OST-së të kryera nga KOSTT, duke iu referuar situatës që ekziston në datën e certifikimit. Në rast të ndonjë ndryshimi, i njëjti do të njoftoj Rregullatorin për arsyet e këtij ndryshimi.


## Vonesa ose praktikësja e investimeve të planifikuara

KOSTT-i i raporton Rregullatorit në baza vjetore mbi zbatimin e projekteve të planifikuara në bazë të Planit Zhvillimor të Transmetimit (PZHT), siç kërkohet sipas kushteve të licencës së OST-së. Në atë raport i shpjegohet Rregullatorit për vonesat ose praktikësen e çfarëdo investimi kapital të përfshirë në PZHT.

Zyrtari për Pajtueshmëri në raportin vjetor do të njoftoj nëse ndonjë nga investimet e planifikuara që të ndërmerren brenda tri viteve të ardhshme të PZHT-së, janë vonuar ose janë praktiksur me kërkesë ose udhëzim të ndonjë organi publik të Shtetit.

## Dividenda

Në raportin e tij vjetor të pajtueshmërisë së KOSTT-së për Rregullatorin, KOSTT-i do të vërtetojë nëse është kërkuar ndonjë dividendë ose është paguar tek aksionari në lidhje me vitin e fundit financiar dhe, në rast se ndonjë dividendë e tillë është kërkuar ose paguar, do të specifikojë shumën përkatëse.

	Programi i Pajtueshmërisë së OST	
		<i>Paqe 7 nga 7</i>
<i>Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST</i>		

## **Ndryshimi**

Procedurat për ndryshim dhe modifikim të këtij Programi të Pajtueshmërisë do të jenë të njëjta si për miratimin e tij.

## **Vlefshmëria dhe hyrja në fuqi e Programit të Pajtueshmërisë**

Programi i Pajtueshmërisë është i vlefshëm për periudhë të pacaktuar dhe hynë në fuqi me datë **27 nëntor 2019**, kur edhe është miratuar nga Bordi i Rregullatorit dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqe të KOSTT-it dhe Rregullatorit.

